

unicef  | for every child

Raporti vjetor
i UNICEF-it në
KOSOVË 2023

HISTORIKU

Në vitin 2023, UNICEF-i vazhdoi punën me partnerët në Kosovë¹ për t'u siguruar që çdo fëmijë të ketë qasje në **shërbime shëndetësore** cilësore dhe edukim, si dhe të gjithë fëmijët të kenë qasje në **mësim cilësor** nga arsimi parafillor deri në atë të mesëm, që të gjithë fëmijët – por veçanërisht ata më të cenuarit – **të jenë të mbrojtur nga dhuna, abuzimi, neglizhenca dhe shfrytëzimi**, dhe që adoleshentët dhe të rinjtë të fitojnë shkathtësitë e duhura për **pjesëmarrje aktive në punë dhe jetë**.

Rimëkëmbja e Kosovës nga efektet e pandemisë COVID-19 është ndikuar nga lufta në Ukrainë, e cila rriti koston e jetesës dhe çmimet e energjisë. **Kosova gjithashtu përjetoi vërrshimet më të rënda në dekadat e fundit, në fillim të vitit 2023**, ku janë prekur rreth 22,000 njerëz në mbarë vendin. **Ndryshimet klimatike dhe degradimi i mjedisit, përfshirë ndotjen e ajrit, po i bëjnë fatkeqësitë si kjo më të shpeshta** në Kosovë, dhe vazhdojnë të ndikojnë në shëndetin dhe mirëqenien e fëmijëve.

Shkalla e vdekshmërisë neonatale, foshnjeve dhe fëmijëve në Kosovë është trefishi i mesatares së Bashkimit Evropian, dhe mbetet më e larta në rajon – me një shkallë të vdekshmërisë së fëmijëve prej 16 për 1000 sipas të dhënave të Anketës së Grupimeve të Treguesve të Shumëfishtë (MICS) dhe gati dy herë më e lartë për komunitetet rom, ashkali dhe egjiptiane (27 fëmijë për 1000).



Imunizimi i fëmijëve ka filluar të rikuperohet pas pengesave gjatë COVID-19, por **vaksinimi në mesin e grupeve të marginalizuara** mbetet shqetësuese.

Përmirësimi i cilësisë së arsimit dhe përafrimi i tij me nevojat e tregut të punës mbetet një sfidë kryesore. Shpenzimet publike për arsimin ishin 4.7 për qind të bruto produktit vendor (BPV) në vitin 2020. Kosova ra pothuajse në fund të rezultateve të testit të Programit për Vlerësimin Ndërkombëtar të Studentëve 2022 (PISA), **duke u renditur e 76-ta nga 80 vendet pjesëmarrëse për lexim, e 77-ta për shkencë dhe e 74-ta për matematikë.**

Gati një e treta (33.7%) e atyre të moshës 15 deri në 24 vjeç në Kosovë nuk janë në arsim, punësim apo trajnim (NEET). Kjo shifër është 34,9% për femrat e reja, krahasuar me 32,7% për meshkujt e rinj. Hendeku gjinor në pjesëmarrjen e fuqisë punëtore në Kosovë është dukshëm më i lartë se në vendet fqinje dhe në mesin e anëtarëve të Bashkimit Evropian, me vetëm 17.1 për qind të grave të punësuar, krahasuar me 50.8 për qind të burrave, sipas të dhënave të vitit 2022.

Të rinjtë kanë vështirësi për të kaluar me sukses kalimin nga shkolla në punë për shkak të problemeve me **cilësinë, rëndësinë dhe gjithëpërfshirjen e sistemit arsimor**, dhe të mospërputhjes midis pritshmërive të të rinjve dhe nevojave ekzistuese në treg



UNICEF/2023/S. Karahodža



Fëmijëve me aftësi të kufizuara u mungon qasja e duhur në arsim, si dhe në shërbime të tjera. Nevojitet më tepër mbështetje financiare për të rritur –shërbimet arsimore si dhe sociale dhe shëndetësore për fëmijët me aftësi të kufizuara.

Pavarësisht përmirësimeve të përgjithshme në alokimet buxhetore për shëndetësinë, arsimin dhe mbrojtjen sociale, përqindja e tyre e PBV-së së investuar në sektorët social është ende relativisht e vogël. Për shembull, Kosova shpenzon 2.7 për qind të PBV-së për shëndetësi, gjysma e mesatares prej 5.4 për qind të PBV-së së vendeve të tjera të Ballkanit Perëndimor; po ashtu, shpenzimet për ndihmën sociale, prej vetëm 0.54 për qind të PBV-së, janë shumë më të ulëta se mesatarja prej 1.9 për qind e PBV-së në Ballkanin Perëndimor. **Ndryshimet ligjore janë ende të nevojshme për të siguruar financim specifik dhe të qëndrueshëm për shërbimet sociale në nivel lokal.**

Mungesa e vazhdueshme e të dhënave administrative të disponueshme, dhe mungesa e sistemeve të të dhënave administrative nëpër sektorë, e ndërlikon më tej sigurimin e të dhënave të përditësuara dhe të zërthyerë për situatën e fëmijëve në Kosovë, duke përfshirë të dhënat për varfërinë e fëmijëve.

UNICEF-i ka vazhduar të mbështesë institucionet e Kosovës dhe shoqërinë civile në përpjekjet e tyre për të adresuar këto sfida të rëndësishme me të cilat përballen fëmijët gjatë vitit 2023, siç përshkruhet në raport.

Programi i UNICEF-it në Kosovë

Në vitin e tretë të Programit të UNICEF-it për Kosovë 2021-2025, puna për avancimin e të drejtave të fëmijëve vazhdoi në tri fusha kryesore:

1

Mbështetja e zhvillimit të fëmijëve të vegjël
(“Dekada e parë e jetës”)



2

Promovimi i fuqizimit dhe zhvillimit të shkathtësive për adoleshentët dhe të rinjtë
(“Dekada e dytë e jetës”)



3

Përfshirja sociale dhe monitorimi i të drejtave të fëmijëve për fëmijët më të cenusur të jetësor.



UNICEF-i në Kosovë përdori një buxhet prej 7.9 milionë dollarësh amerikanë në vitin 2023 dhe siguroi fonde bujare shtesë nga Qeveritë e Luksemburgut dhe Austrisë, dhe Fondi i Kombeve të Bashkuara për ndërtimin e paqes, që do të përdoren kryesisht gjatë viteve 2024-2025. Fondet e reja të premtuara do të mbështesin iniciativat për zhvillimin e fëmijërisë së hershme dhe zhvillimin e shkathtësive dhe fuqizimin e adoleshentëve dhe të rinjve.

Arritjet për fëmijët e vegjël

Kujdesi dhe mbështetja ndaj fëmijëve

Në vitin 2023, UNICEF-i vazhdoi të përmirësoj shkathtësitë e ofruesve të kujdesit shëndetësor dhe profesionistëve të tjerë të vijës së parë për të ofruar shërbime kritike për nënat shtatzëna dhe fëmijët e vegjël. Ministria e Shëndetësisë ka arritur me shërbime shëndetësore dhe imunizim tek më shumë komunitete, siç janë fëmijët dhe prindërit.

Programi i mbështetur nga UNICEF-i për vizitat në shtëpi për gratë shtatzëna dhe prindërit e rinj, i cili është aktiv në 38 komuna, vazhdoi të zgjerohej, duke arritur mbi 14 për qind më shumë fëmijë se në vitin 2022 dhe, për herë të parë, ishte në gjendje të ofronte mbështetje për nga aspekti shëndetësor dhe zhvillimor për mbi 80 për qind të fëmijëve të lindur në vitin 2023. UNICEF-i gjithashtu vazhdoi të mbështesë programin me fokus në grupet e cenushme, përkatësisht komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian.

Në vitin 2023, 10 për qind të të gjitha vizitave në shtëpi iu bënë fëmijëve nga këto komunitete, megjithëse ato përbëjnë vetëm rreth 2 për qind të popullsisë së përgjithshme.



Me mbështetjen e UNICEF-it, **Analiza e parë e situatës për ndërhyrjen në fëmijërinë e hershme në Kosovë ka përfunduar**, duke ofruar një udhëzues për zhvillimin e politikave dhe programeve për fëmijët e vegjël në rrezik, në vitet e ardhshme. Përveç kësaj, me mbështetjen e UNICEF-it, Ministria e Shëndetësisë ka përshtatur dhe miratuar **një instrument të ri për monitorimin e zhvillimit**—Udhëzuesi Ndërkombëtar për Monitorimin e Zhvillimit të Fëmijëve. Ky instrument i parë i standardizuar në Kosovë është një hap i rëndësishëm drejt përmirësimit të identifikimit të hershëm të fëmijëve në rrezik nga aftësia e kufizuar dhe vonesat zhvillimore nga sistemi shëndetësor dhe do të pilotohet në vitin 2024.

UNICEF-i gjithashtu vazhdoi forcimin e sistemit të imunizimit në Kosovë, duke u fokusuar në rimëkëmbjen nga ngecja gjatë pandemisë COVID-19. Me mbështetjen e UNICEF-it, **25 për qind e punonjësve të kujdesit shëndetësor parësor të vijës së parë, duke përfshirë mjekët dhe infermierët, kanë përmirësuar shkathhtësitë e tyre të komunikimit ndërpersonal për imunizimin**. UNICEF-i mbështeti Institutin Kombëtar për Shëndetin Publik për të zhvilluar 30 mikro-plane komunale për imunizimin dhe vaksinimin e avancuar të popullatave të cënueshme – përkatësisht komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptianë – përmes **Fushatës derë më derë dhe sesione informuese që identifikuan 1200 fëmijë të pavaksinuar**, nga të cilët 495 janë vaksinuar.

UNICEF-i gjithashtu mbështeti **futjen e vaksinave PCV dhe të rotavirusit në kalendarin kombëtar të imunizimit** dhe, pas prokurimit të pajisjeve të reja të zinxhirit të ftohtë në vitin 2022, punoi me Ministrinë e Shëndetësisë për të përmirësuar menaxhimin e zinxhirit të ftohtë, menaxhimin e furnizimit me vaksina dhe administrimin e vaksinave.

Janë blerë dhe instaluar 5 dhoma të reja ftohëse dhe 8 ngrirës ultra të ulët për Magazinimin Qendror të Vaksinave, së bashku me 214 frigoriferë vaksinash dhe 56 ngrirës të vaksinave, për të siguruar që vaksinat të mbahen në temperaturën e duhur.

Edukimi i hershëm

Viti 2023 shënoi një vit të rëndësishëm sa i përket progresit në edukimin në fëmijërinë e hershme (EFH) në Kosovë.

Ligji i parë i Kosovës për edukimin në fëmijëri të hershme, i mbështetur nga UNICEF-i, u miratua në mesin e vitit 2023. Ligji parashikon kornizën e politikave të nevojshme për të përmirësuar cilësinë dhe mbulimin e shërbimeve të kujdesit dhe arsimit për fëmijët e moshës 0-6 vjeç. Për herë të parë, zyrtarizohen forma të ndryshme të ofrimit të arsimit parashkollor – duke përfshirë partneritetet me bazë në komunitet dhe ato publiko-private – të cilat do të ndihmojnë në zgjerimin e qasjes për më shumë fëmijë, dhe parasheh **kurrikulën e parë zyrtare parashkollore për Kosovën**. Avokimi i UNICEF-it kontribuoi në ndarjen e fondeve nga qeveria për ndërtimin e 17 objekteve të reja parashkollore dhe ripërdorimin e 5 objekteve të tjera shkollore; këto pritet të sigurojnë **shërbime për rreth 2000 fëmijë të tjerë** në këtë grupmoshë.

UNICEF-i, gjithashtu, vazhdoi të punojë në terren për të zgjeruar shërbimet e edukimit në fëmijërinë e hershme, duke përfshirë punën me autoritetet lokale dhe shoqërinë civile për të promovuar **qendrat e nxënies në fëmijëri të hershme me bazë në komunitet**.

Më shumë se 600 fëmijë (47 për qind vajza), duke përfshirë 10 për qind nga komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian, morën mbështetje për nxënien dhe zhvillimin e hershëm në 16 qendra të mbështetura nga UNICEF-i në nëntë komuna. Nga këto qendra, katër janë integruar në buxhetet komunale dhe katër janë themeluar rishtazi në vitin 2023.

Foleja, aplikacioni inovativ për prindër, i zhvilluar nga UNICEF-i, vazhdoi të zgjerojë shtrirjen e tij në Kosovë dhe tani ka një bazë përdoruesish me **15,000 prindër dhe kujdestarë** (22 për qind meshkuj). Aplikacioni është i disponueshëm në gjuhën shqipe dhe serbe dhe ofron **informacione thelbësore dhe të besueshme në lidhje me shëndetin, kujdesin, prindërimin dhe edukimin për prindërit e fëmijëve të moshës 0-6 vjeç.**



UNICEF /2023/SS/Krahudo

Arritjet për adoleshentët dhe të rinjtë

Edukimi gjithëpërfshirës

Për të përmirësuar pjesëmarrjen në arsim dhe rezultatet e të nxëniet të fëmijëve të marginalizuar, **UNICEF-i ka mbështetur tetë qendra mësimore në komunitet dhe shkolla në mbarë Kosovën** për të ofruar mësim jashtë shkolle, ndihmë për detyrat e shtëpisë dhe aktivitete rekreative të dizajnuara për të përmirësuar rezultatet e të nxëniet të fëmijëve, kompetencën socio-emocionale dhe shkathtësitë jetësore. **1,168 fëmijë nga komuniteti rom, ashkali dhe egjiptian kanë marrë mbështetje në baza ditore në vitin 2023**, dhe 449 mësimdhënës dhe staf nga qendrat mësimore në komunitetet e tyre janë trajnuar për arsimin gjithëpërfshirës, ndërmjetësimin, parandalimin e braktisjes së shkollës dhe mbrojtjen e fëmijëve.

Për të adresuar sfidën e vazhdueshme të braktisjes së shkollës, e cila prek në mënyrë disproporcionale fëmijët dhe adoleshentët nga grupet e marginalizuara, veçanërisht në nivelin e mesëm, **UNICEF ndihmoi në krijimin dhe trajnimin e 249 ekipeve lokale të parandalimit dhe reagimit kundër braktisjes dhe mosregjistrimit në arsim**. Këto ekipe udhëhiqen nga autoritetet komunale dhe fokusohen në identifikimin e hershëm, raportimin dhe bashkëpunimin ndërsektorial për menaxhimin e rasteve. Për më tepër, **147 nxënës (63 për qind femra) u trajnuan për parandalimin e braktisjes së shkollës dhe 15 komuna morën ndihmë për hartimin e planeve lokale të veprimit për parandalimin e braktisjes, ndihmë për hartimin e planeve lokale të veprimit për parandalimin e braktisjes**.



Për të vendosur themelet për një sistem arsimor gjithëpërfshirës në mbarë Kosovën, **UNICEF-i vendosi 25 mësimdhënës ndihmës në pesë komuna për t'i mbështetur fëmijët me aftësi të kufizuara në klasë.**

Këta, së bashku me 243 asistent mbështetës të sistemuar nga MASHTI, do të ndihmojnë qeverinë të arrijë objektivin e saj prej 500 asistent mbështetës deri në vitin 2026. **Pesëmbëdhjetë klasë burimore, të cilat përfshijnë teknologji ndihmëse të teknologjisë së lartë për të ndihmuar fëmijët me aftësi të kufizuara, u prezantuan për herë të parë në Kosovë.**

Shkathësitë e duhura për jetën dhe punën

Nëpërmjet programeve të vazhdueshme të zhvillimit të shkatheësive joformale të udhëhequra nga të rinjtë, duke përfshirë UPSHIFT, PONDER dhe PODIUM, UNICEF dhe partnerët e tij **arritën dhe angazhuan 2056 adoleshentë dhe të rinj (1,142 vajza)**. Për më tepër, UNICEF-i ka mbështetur **23 projekte të udhëhequra nga të rinjtë që adresojnë ndotjen e ajrit dhe çështjet mjedisore**, me theks parësor në edukimin e të rinjve dhe zgjerimin e hapësirave të gjelbra për të promovuar mirëqenien e komunitetit. Iniciativat promovuan diversitetin dhe përfshirjen, me grupe të ndryshme që zbatonin zgjidhje për komunitete të ndryshme. Këto përpjekje synonin të angazhonin një gamë të gjerë palësh të interesit dhe të adresonin sfidat mjedisore në mënyrë gjithëpërfshirëse, duke reflektuar një përkushtim ndaj vepërimit kolektiv dhe përfshirjes së komunitetit.

Së bashku me agjencitë e tjera të OKB-së, UNICEF-i mbështeti Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit për të zhvilluar **Strategjinë e re të Kosovës për Rininë (2023-2032)**. Strategjia ka në qendër qasjen inovative dhe ndërsektoriale për të trajtuar sfida të shumëfishta, **duke përfshirë ato me të cilat përballen veçanërisht vajzat dhe të rejtat**, në zhvillimin e aftësive dhe tranzicionin në tregun e punës, duke përfshirë normat kufizuese sociale dhe dhunën me bazë gjinore, dhe përcakton masat dhe veprimet e politikave që synojnë të rinjtë e marginalizuar në Kosovë.

Në vitin 2023, **Programi Kosova Generation Unlimited (K-GenU) u zgjerua dukshëm në 744 organizata pjesëmarrëse**, dhe tani është platforma kryesore që ofron mundësi për punë praktike për të rinjtë, me mbështetje financiare dhe operacionale nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve. Në vitin 2023, **656 të rinj (63 për qind femra) e përmirësuan punësueshmërinë e tyre përmes praktikave profesionale tre mujore me pagesë, të plotësuara me mentorim dhe trajnim**.

U forcua bashkëpunimi me sektorin privat dhe agjencitë e tjera të Kombeve të Bashkuara, përfshirë Misionin e Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UN-MIK). Asambleja e pestë e Rinisë së Kombeve të Bashkuara solli 150 aktivistë të ndryshëm të rinj nga mbarë Ballkani Perëndimor në Prishtinë për të punuar së bashku mbi temat e **ruajtjes së paqes; puna në komunitet dhe vullnetarizmi; mjedisi gjithëpërfshirës; ndryshimet klimatike dhe pjesëmarrja e të rinjve në qeverisjen qendrore dhe lokale si dhe në organizatat ndërkombëtare**. Këto partneritete e ndihmojnë UNICEF-in për të adresuar sfidat kryesore për zhvillimin gjithëpërfshirës të adoleshentëve dhe të rinjve në Kosovë.



Transformimi digjital në arsim

UNICEF, duke punuar ngushtë me Ministrinë e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit (MASHTI), ka luajtur një rol kyç në avancimin e arsimit në Kosovë përmes zhvillimit dhe zbatimit të **Platformës shkollat.org**. Kjo platformë, e përshtatur me nevojat unike të Kosovës, shërben si një qendër digjitale gjithëpërfshirëse për burime dhe mbështetje arsimore. **Integrimi i tij në Planin Strategjik të Arsimit të Kosovës (PSAK) 2022-2026 nënkupton një moment historik të rëndësishëm në transformimin digjital të sistemit të arsimit parauniversitar.**

Një nga kontributet kryesore të UNICEF-it ka qenë **sigurimi i ekspertizës teknike të vazhdueshme për MASHTI-në**, veçanërisht në mungesë të një divizioni të dedikuar të TIK-ut, duke siguruar funksionimin dhe mirëmbajtjen e platformës online. Për më tepër, UNICEF ka mbështetur në mënyrë aktive platformën duke e pasuruar përmëmbajtjen e saj digjitale dhe duke përmirësuar qasjen në pajisje. Veçanërisht, mbështetja teknike e UNICEF-it e ka mundur **zhvillimin e një sistemi të përditësuar të pajisjes digjitale për kërkesa**, ka ristrukturuar procesin e alokimit dhe ka forcuar efikasitetin administrativ në shpërndarjen e pajisjeve të TIK-ut në shkolla.

Përveç zhvillimit të infrastrukturës, UNICEF-i ka investuar në zhvillim profesional të edukatorëve, me **68 mësimdhënës që marrin trajnime të specializuara për aftësitë digjitale dhe përdorimin efektiv të platformave mësimore**. Ky investim në kapitalin njerëzor vë në pah përkushtimin e UNICEF-it për të pajisur edukatorët me mjetet dhe njohuritë e nevojshme për të shfrytëzuar teknologjinë për rezultate të përmirësuara të të nxëniet. Sa i përket të së ardhmes, UNICEF-i mbetet i përkushtuar për **zhvillim të mëtejshëm dhe përdorim të gjerë të Shkollat.org, duke njohur rolin e saj kryesor në nxitjen e iniciativave të mësimin digjital në mbarë Kosovën.**

Arritjet në përfshirjen sociale dhe monitorimin e të drejtave të fëmijës

Përmirësimi i shërbimeve për fëmijët në rrezik

Në vitin 2023, UNICEF-i ndihmoi për të sjellë përmirësim në kornizën e politikave dhe kapacitetet e vijës së parë për mbrojtjen e fëmijëve dhe mbrojtjen sociale. Megjithatë, **disponueshmëria e të dhënave, burimet e kufizuara njerëzore dhe vonesat në proceset legjislative penguan përparimin e përgjithshëm.**

Zbatimi i Ligjit për Mbrojtjen e Fëmijëve ka përparuar me **miratimin e nëntë udhëzimeve administrative shitesë.** Është zhvilluar një program trajnimi për zbatimin e Ligjit për profesionistët e mbrojtjes së fëmijëve dhe punëtorët e tjerë të vijës së parë. Mbështetja dhe ndihma e UNICEF-it çuan në përmirësim në kujdesin alternativ për fëmijët pa kujdes prindëror, duke përfshirë **një rritje prej 40 për qind në pagesat mujore për fëmijët në kujdes strehues dhe në farefisni, ku kanë përfituar 485 fëmijë.**

Ligji për Shërbime Sociale dhe Familjare i mbështetur nga UNICEF, i miratuar në vitin 2023, do të zgjerojë fushën e shërbimeve, do të krijojë modele të reja shërbimi dhe do të ndihmojë në sigurimin e të drejtës për shërbime sociale për të gjithë individët në nevojë, pavarësisht nga urgjenca apo rreziku. Një raport i mbështetur nga UNICEF-i mbi gjendjen e qendrave për punë sociale ndihmoi në përshpejtimin e miratimit të Ligjit dhe rritjen e financimit për shërbimet sociale, **ku Ministria e Drejtësisë shpërndau 5 milionë euro për OJQ-të e licencuara që ofrojnë shërbime të tilla në vitin 2023, një rritje prej 50 për qind nga viti 2022.**

UNICEF kontribuoi në një modul të ri trajnimi mbi 16 masa të reja alternative për të miturit në konflikt me ligjin. **Të 120 të miturit në Institucionin Korrektues të Arsimit u trajanu trajnim dhe u pajisën me mjete të ndryshme për kurset profesionale.**

UNICEF gjithashtu **riti kapacitetet e nxënësve, mësimeve dhe të drejtuesve të shkollave në 30 shkolla** për të krijuar mjedise pa dhunë dhe për të dhënë udhëzime për përdorim të sigurt të internetit.

Përfshirja e Fëmijëve me Aftësi të Kufizuara

UNICEF-i mundësoi **rehabilitim të bazuar në komunitet për 1,541 fëmijë me aftësi të kufizuara (43 përqind femra) dhe për 1,412 prindër (66 përqind nëna)** në 25 komuna. Për më tepër, ngritja e kapaciteteve nga UNICEF për 310 zyrtarë dhe praktikues përmirësoi shërbimet gjithëpërfshirëse për fëmijët me aftësi të kufizuara.

Pavarësisht progresit, **vazhdojnë sfidat e tilla si hapësirat publike dhe transporti i paqasshëm, mungesa e arsimit gjithëpërfshirës, shërbimet e pamjaftueshme shëndetësore dhe sociale dhe kornizat e pamjaftueshme ligjore**, duke vështirësuar jetën e njerëzve dhe fëmijëve me aftësi të kufizuara. Për të adresuar këtë çështje, në shtator të vitit 2023, UNICEF-i gjithashtu nisi një **Fushatë 22-mujore për promovimin e përfshirjes së fëmijëve me aftësi të kufizuara**, duke bashkuar shumë akterë, përfshirë institucionet e Kosovës, Zyrën e Bashkimit Evropian në Kosovë, autoritetet komunale dhe organizatat e personave me aftësi të kufizuara.

#Zgjidhelomshin, një instalacion artistik u hap në tre komuna, duke simbolizuar sfidat e shumta dhe të ndërthurura me të cilat përballen fëmijët me aftësi të kufizuara në jetën e tyre të përditshme.

Fushata mbledhi vendimmarrësit, kryetarët e komunave, prindërit, fëmijët dhe partnerët dhe **janë nënshkruar 500 kërkesa që kërkojnë politika publike për prioritetimin e të drejtave të fëmijëve dhe individëve të tjerë me aftësi të kufizuara**. Kjo fushatë do të vazhdojë në vitin 2024 duke bërë thirrje për qasje në hapësirat publike, mjedise mësimore gjithëpërfshirëse dhe rritje të përpjekjeve për të luftuar stigmën dhe diskriminimin ndaj fëmijëve me aftësi të kufizuara.



UNICEF/2023/S. Karahoda

Përmirësimi i financimit dhe koordinimi për të Drejtat e Fëmijëve

Tridhjetë e katër komuna themeluan Ekipet për të Drejtat e Fëmijëve të kryesuar nga kryetarët e komunave dhe katër plane të Ekipit të Veprimit për të Drejtat e Fëmijëve u miratuan nga kuvendet komunale. Këto plane do të ofrojnë orientimin strategjik, ndërhyrjet dhe burimet **për mekanizma dhe shërbime komunale cilësore dhe gjithëpërfshirëse që mundësojnë mbrojtjen dhe zhvillimin e fëmijës.**

Komiteti Ndërministror për të Drejtat e Fëmijëve, i udhëhequr nga kryeministri, u takua dy herë për të diskutuar statusin e të drejtave të fëmijëve në Kosovë. Fëmijët nga komunitetet më të marginalizuara, përfshirë ata me aftësi të kufizuara, ishin të pranishëm në takime. Ata i drejtuan nevojat dhe kërkesat e tyre drejt vendimmarrësve, **duke theksuar rëndësinë e realizimit të të drejtave të tyre, adresimin e çështjeve urgjente si ndryshimet klimatike, përmirësimin e cilësisë së arsimit dhe sigurimin e qasjes në kujdesin shëndetësor dhe shërbime arsimore.**

Partneritetet

Rezultatet e përshkruara në raport u bënë të mundura falë mbështetjes bujare të partnerëve të mëposhtëm:



UNICEF-i në Kosovë do të dëshironte gjithashtu të njohë shumë qeveri dhe partnerë të tjerë që kontribuojnë në financimin bazë dhe tematik të UNICEF-it në nivel global, pasi këto burime fleksibël kanë qenë të rëndësishme në arritjen e rezultateve tona për fëmijët.

unicef  | for every child

për çdo fëmijë,
çdo të drejtë



UNICEF Kosova

“Pejton, objekti Ramiz Sadiku”, C3/2A
Prishtinë/ Kosovë

Web: www.unicef.org/kosovoprogramme

Facebook: UNICEF Kosovo Programme

Instagram: [unicefkosovoprogramme](https://www.instagram.com/unicefkosovoprogramme)

Twitter: UNICEFKosovo